

## Parime për rritjen e kishës (4:7–16)

**D**y anije luftarake kishin dalë në det për manovra. Koha ishte shumë e keqe, me shi të rrëmbyer, erëra të forta dhe det të trazuar. Koha e keqe vazhdoi gjithë natën, ndërsa mjegulla po binte vende-vende. Kapiteni qëndronte në urëkomandë për të parë situatën nga afër.

Pak pasi u errësua, roja që vëzhgonte thirri: «Dritë, në anën e djathtë të bashit të anijes.»

Kapiteni pyeti: «Është e qëndrueshme apo e lëvizshme?»

«E qëndrueshme, kapiten.»

Dukej qartë se ishin në një drejtim me kursin e një anijeje tjetër dhe kishte rrezik të përplaseshin.

Kapiteni udhëzoi: «Dërgoju sinjal asaj anijeje: “Jemi në kurs përplasjeje. Këshilloj të ndryshoni kursin 20 gradë.”»

Përgjigja u kthye: «Këshilloj që ju të ndryshoni kursin 20 gradë.»

Kapiteni urdhëroi të dërgohet një mesazh tjetër: «Unë jam kapiten. Ndrysho kursin 20 gradë.»

«Unë jam detar i klasit të dytë», ishte përgjigja. «Më mirë të ndryshoni kursin 20 gradë.»

Në këtë kohë kapiteni u nervozua. «Dërgo: “Unë jam anije luftarake. Ndryshoni kursin 20 gradë.”»

Përgjigja erdhi përsëri: «Unë jam fanar. Ndryshoni kursin 20 gradë.»

Kapiteni menjëherë urdhëroi të ndryshonin kursin.

Kapiteni po vepronte duke e parë situatën nga

këndvështrimi i tij. Ai vazhdoi të vepronte kështu deri sa mori vesh të vërtetën. Kur mori vesh se ajo dritë vinte nga një fanar, ai vendosi të ndryshojë kursin.

Fanari mund të përfaqësojë ato që i quajmë parime. Bibla përmban shumë parime të qëndrueshme (si fanar deti). Ato kurrë nuk ndryshojnë. Ato janë absolute. Janë parime që kanë qenë të vërteta dje, që janë të vërteta sot dhe që do të jenë të vërteta nesër.

Bibla jep parime të tilla për martesën, të tilla si parimi i pasjes vetëm një burrë e vetëm një grua në jetë (Romakëve 7:1–3). Ajo jep parime të pandryshueshme për prindërit, të tilla si rritja e fëmijëve në një mënyrë të tillë që t’i çojë ata te Jezusi (Efesianëve 6:4). Ajo gjithashtu jep udhëzime për fëmijët (6:1–3), për punëdhënësit (6:5–9), për përdorimin e parave (1 Timoteut 6:9–10), për bërjen e planeve (Jakobi 4:13–15) dhe për gjithë jetën (2 Pjetër 1:3).

Dhjata e Re, gjithashtu, na jep parime të qëndrueshme për kishën. Letra e Efesianëve përmban disa prej këtyre. Të gjitha bekimet frymërore që jep Perëndia gjenden në Krishtin (1:3). Krishti është kreu i kishës (1:22). Kisha është trupi i Krishtit (1:23). Jemi shpëtuar me anë të hirit nëpërmjet besimit (2:8). Kristianët, të gjithë së bashku, janë anëtarë të një trupi (3:6). Ka një trup dhe një Frymë; një shpresë; një Zot, një besim, një pagëzim; një Perëndi dhe At (4:4–6).

Duke filluar nga 4:7 flitet për rritjen e kishës.

Jepen disa parime (udhëzime) që mund të ndihmojnë rritjen e vazhdueshme të kishës.

## PARIME TË PAMJAFTUESHME PËR RITJEN E KISHËS

Para se të shohim parimet biblike, le të reflektojmë mbi parimet e mëposhtme, gjerësisht të pranuar për rritjen e kishës. Edhe pse mund të jenë të dobishme, ato shpesh mbitheksohen. Të marra veç e veç ato janë të pamjaftueshme.

1. «Rritja e kishës ndodh kur planifikojmë mirë dhe kur zbatojmë programe moderne.» Shumë libra janë shkruar për të na treguar se çfarë ka sukses në rritjen e kishës. Ata shpjegojnë se si arrihet rritja e kishës me anë të vizitave, marketingut, predikimit, klasave ku studihet Bibla dhe shumë të tjera. Përveç librave për rritjen e kishës, studjohen gjithashtu edhe bashkësitë e suksesshme. Drejtues bashkësisish shkojnë në këto kisha të suksesshme për të parë se çfarë bëjnë ata që janë kaq të suksesshëm. Ata blejnë libra dhe kaseta, shkojnë në seminare dhe pastaj kthehen në shtëpi, të bindur se kanë në duar planin për rritjen e bashkësisë së tyre.

2. «Kisha rritet kur ajo ka një personel (predikues, dhjakë [anëtarë që kujdesen për aspekte të ndryshme të jetës dhe aktivitetit të bashkësisë], etj.) të aftë dhe të përgatitur mirë.» Sa më efektiv të jetë stafi, aq më shumë pritet që të rritet kisha.

3. «Kisha rritet kur çdo anëtar trajnohet dhe përfshihet në programet e kishës.» Drejtuesit e bashkësisë i kërkojnë çdo anëtar të përfshihet në programet e bashkësisë. Ka shumë njerëz që mendojnë se duke trajnuar persona të caktuar për një lloj të caktuar shërbese në bashkësi dhe duke i punësuar ata (me rrogë) do të shkaktojnë rritjen e kishës.

4. «Rritja e kishës mund të matet me rritjen numerike të pjesëmarrësve në takimet e kishës, me rritjen e kontributit financiar dhe të aktiviteteve të sponsorizuara nga kisha.» Kur njerëzit mësojnë se kisha e ka dyfishuar numrin e anëtarëve dhe kontributin financiar gjatë vitit të fundit, ata mendojnë: «Kjo është një bashkësi që rritet. Ata janë në rrugën e rritjes.» Nganjëherë, kur vëmë re se një bashkësi është e zënë me takime, seminare dhe aktivitete të ndryshme, arrijmë në përfundimin se «ajo bashkësi është në rritje».

Këto katër parime zbatohen sot nga shumë kisha. Secili nga këto parime ka vlerën e vetë, por, të

vetëm, këta parime janë të pamjaftueshëm për të shkaktuar rritjen e kishës.

## PARIME TË QËNDRUESHME PËR RITJEN E KISHËS

Ndërsa shqyrtojmë disa parime të qëndrueshme (si fanari i detit) lidhur me rritjen e kishës, duhet të lexojmë çfarë u shkroi Pali efesianëve:

Po secilit nga ne iu dha hiri sipas masës së dhuntisë së Krishtit. Për ç'ka Shkrimi thotë: «Kur ai u ngjiti lart, ai e burgosi burgosjen dhe u dha dhurata njerëzve». Tani kjo: «Ai u ngjiti», ç' do thotë tjetër përveç se ai më parë edhe kishte zbritur në pjesët më të ulta të dheut? Ai që zbriti është po ai që edhe u ngjiti përmbi të gjithë qiejt, për të përmbushur të gjitha gjërat. Dhe ai vetë i dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë dhe të tjerë si barinj e mësues, për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes të Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnja, të lëkundur dhe të transportuar nga çdo erë doktrineje, nga mashtrimi i njerëzve, nga dinakëria e tyre nëpërmjet gënjeshtrove të gabimit, por, duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti. Prej të cilit gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri (4:7-16).

### Parimi i parë

*Ashtu si shpëtimi, rritja e kishës është çështje e hirit.* Pali tha: «Po secilit nga ne iu dha hiri sipas masës së dhuntisë së Krishtit» (4:7). Në këtë varg, Pali flet për hirin e shpëtimit (2:8) dhe për hirin që na jepet si ndihmë. Hiri që na jepet si ndihmë është aftësia për të bërë diçka të veçantë për lavdinë e Perëndisë. Pali e përcjell këtë ide te Romakëve 12:6: «Duke pasur dhunti të ndryshme sipas hirit që na u dha». Ky hir është çelësi për rritjen e vërtetë të kishës. Rritja nuk ndodh vetëm si rezultat i planeve apo strategjive që bëjmë. Ajo ndodh nëpërmjet hirit që Jezusi i jep çdo kristiani, hir që e bën secilin të aftë të bëjë diçka në kuadrin e kishës.

Më pëlqen ajo që shkroi Paul Stevens për këtë:

Në një kishë që e vë re se çdo anëtar i është dhënë hir nga Krishti, çdo anëtar i saj do të çmohet, çdo shërbesë do të vlerësohet, çdo përvojë e ndryshme e hirit të Krishtit do të ruhet. Një mjedis i tillë do të komunikojë këtë: «Kemi nevojë për ju!»

Çdo anëtar është i nevojshëm! Kur të shkoni në kishë të dielën që vjen, shikoni përreth. Do të

shikoni se rrethoheni nga aq shprehje të dukshme të hirit të Perëndisë, sa edhe numri i anëtarëve të kishës që ndodhen atje. Perëndia ofron hirin dhe dhuntitë e nevojshme për rritjen e kishës nëpërmjet këtij lloji hiri të përmendur më sipër. Ky hir që të bën të aftë të bësh diçka të veçantë për Perëndinë u jepet gjithë kristianëve.

### **Parimi i dytë**

*Kisha rritet kur të gjithë kristianët e përdorin hirin që u është dhënë.* Shumë bashkësi rendisin emrat e pleqve, dhjakëve dhe shërbenjësve në krye të letrave që dërgojnë. Ata që radhiten si «shërbenjës» janë zakonisht predikuesit. Kjo mund të çojë në keqkuptime. Në të vërtetë, shërbenjësit e një kisha lokale janë të gjithë anëtarët e saj. Ju jeni po aq shërbenjës sa edhe ata që paguhen me rrogë në kishë. Ju jeni shërbenjës të hirit të Krishtit.

Te vargu 4:16 lexojmë: «Prej të cilit [Krishtit] gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.» Ky varg na bën që të rishqyrtojmë mënyrën se si i inkurajojmë njerëzit për t'u përfshirë në punën e Perëndisë. Unë gjithmonë kam ndjekur këtë mënyrë: Në qoftë se duhej ndihmë për një program të caktuar, përpiqesha të gjeja njerëzit që do të bënin punën. Bëja ç' ishte e mundur që të vija njerëzit e duhur në punët e ndryshme të këtij programi. Por, një mënyrë më e mirë do të ishte t'u thosha anëtarëve: «Çfarë do t'ju pëlqente më shumë të bënit për Zotin? Çfarë mendoni se do të donte Jezusi që të bënit për të lavdëruar emrin e Tij? Duam t'ju krijojmë mundësinë për ta bërë këtë.»

Çdo kristian është shërbenjës i hirit në kishë. Jezusi ju ka vendosur në kishë me një qëllim të caktuar dhe do që ju të shërbeni në një mënyrë të caktuar në atë bashkësi.

### **Parimi i tretë**

*Kisha rritet kur drejtuesit e saj janë të përkushtuar ndaj përgatitjes së njerëzve për shërbesë.* Pali tha:

Dhe ai vetë [Krishti] i dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë dhe të tjerë si barinj e mësues, për përsosjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit (4:11–12).

I kemi zbatuar udhëzimet e Palit në klasat

biblike, në programet e trajnimit dhe në seminare, pra kemi bërë çdo gjë për t'u mësuar anëtarëve mjeshtëri që t'i përdorin në kishë. Megjithatë, ky është një koncept i kufizuar i idesë së «përgatitjes». Përgatitje (stërvitje) do të thotë të ndihmosh dikë për të zhvilluar aftësinë për të shërbyer; por akoma më shumë, do të thotë të *formosh karakterin, mendjen dhe zemrën e çdo anëtari.*

Jezusi ishte mjeshtër në përgatitjen e njerëzve për të shërbyer. Ai zgjodhi dymbëdhjetë burra dhe shpenzoi tre vjet për t'i përgatitur ata. Nuk kam dëgjuar se Jezusi u kërkoi atyre të mësonin përmendësh dhjetë hapat për shërbesën ndaj të sëmurëve me lebër. Në asnjë vend nuk thuhet se Ai u mësoi atyre si të administronin bashkësinë. Përkundrazi, Ai shpenzoi kohë me ta. Ata panë fuqinë e Tij dhe ranë në gjunjë para Tij. Ata e dëgjuan të lutej dhe mësuan të luten. Duke qenë me Jezusin, dishepujt mësuan se si të jetojnë si fëmijë të Perëndisë.

Drejtuesit e kishave sot duhet ta ndjekin këtë shembull. Duke qenë me Jezusin, pra, duke shpenzuar kohë me Të nëpërmjet Fjalës, në shërbimin e adhurimit dhe në lutje, kristianët do të mësojnë se si të jetojnë si fëmijë të Perëndisë. Kemi nevojë për shërbime adhurimi gjatë të cilave zemrat tona ndihen të etura për Perëndinë. Kemi nevojë për udhëzime nga Fjala e Perëndisë e cila na transformon dhe na përtërin mendjen. Kemi nevojë të kemi marrëdhënie me kristianët e tjerë, marrëdhënie që do të thellojnë përkushtimin dhe besimin ndaj njëri-tjetrit. Jezusi u bën thirrje drejtuesve të kishës të jenë të përgatitur për t'u krijuar anëtarëve kushte për t'u rritur shpirtërisht. Mund të përmendim organizimin e takimeve midis anëtarëve për studimin e Biblës, për lutje, shërbimet e ndryshme ndaj atyre që janë në nevojë etj.

### **Parimi i katërt**

*Rritja e kishës matet nga pjekuria në sytë e Perëndisë.* Njerëzit e Perëndisë janë të përgatitur «për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit» (4:12). Pali bëri thirrje që kjo të ndodhë «derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur» (4:13). Ai theksoi përsëri procesin e përsosjes duke përmendur rritjen e trupit (4:15) dhe ndërtimin e tij (4:16). Shkrimet e Palit përshkohen nga ideja e përsosjes.

Rritja e kishës në sytë e Perëndisë është përsosja,

jo numrat. Perëndia shikon në zemrat tona për imazhin e Dikujt që Ai e njeh. Ai shpreson të gjejë imazhin e Birit të Tij të fillojë të shfaqet në ne. Ai do që ne të kemi mendjen e Krishtit.

### **KONKLuzion**

Shqyrtoam katër parimet e qëndrueshme për rritjen e kishës. Në qoftë se i zbatojmë këto parime, Perëndia do ta shikojë bashkësinë tonë si bashkësi në rritje.

Po për sa na përket neve si individë? A po ia ofrojmë dhuntinë tonë bashkësisë ku jemi anëtarë? Ne mbartim brenda vetes hirin e Jezusit që duhet të

ndahet me të tjerët. A jemi shërbenjës besnikë të atij hiri?

Drejtues të bashkësive, a po shpenzoni kohën me përsosjen e programeve apo po ndihmoni anëtarët të përdorin talentet e tyre të veçanta në kishë? A po bëni ç'është e mundur për të krijuar një mjedis në të cilin njerëzit mund të zhvillojnë frymën e shërbimit?

A ka si synim secili prej nesh përsosmërinë? A po kërkojmë të kemi mendjen e Jezusit? Krishti na ka siguruar se, në qoftë se çdonjëri prej nesh bën atë që i takon, atëherë kisha do të rritet në një mënyrë që lavdëron emrin e Perëndisë.

Autor: *Rusty Peterman*  
Marrë nga seria: "*Efësiatëve*"  
© 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara